VENDIM
Nr.308, datë 25.3.2009

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES PËR SHITJEN E AKSIONEVE TË MBETURA SHTETËRORE NË SHOQËRINË "ALBANIAN MOBILE COMMUNICATIONS", SHA (AMC), NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS DHE "COSMOTE MOBILE TELEKOMMUNICATIONS", S.A

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.8515, datë 21.7.1999 "Për privatizimin e shoqërisë anonime "Albanian Mobile Communications" (AMC)" dhe të ligjit nr.9874, datë 14.2.2008 "Për ankandin publik", me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes për shitjen e aksioneve të mbetura shtetërore në shoqërinë "Albanian Mobile Communications", sha (AMC), ndërmjet Republikës së Shqipërisë përfaqësuar nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe "Cosmote Mobile Telekommunications", s.a, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

MARRËVESHJE SHITJE AKSIONESH

Kjo marrëveshje shitje aksionesh "MSHA" lidhet ndërmjet:

1. Republikës së Shqipërisë duke vepruar nëpërmjet Ministrisë se Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Blvd.Dëshmorët e Kombit, nr.2, Tiranë, Shqipëri, të përfaqësuar nga Zëvendësministri, Z.Enno Bozdo, rregullisht i autorizuar sipas kësaj Marrëveshjeje, dhe duke vepruar në emër e për llogari të Republikës së Shqipërisë,

Në vijim referuar si "METE" ose "Shitësi",

dhe

2. "Cosmote Mobile Telecommunications" S.A, një shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionit të Greqisë, selia e së cilës ndodhet në 44 Kidfias Ave, 5th floor, Suite 507, Marousi, Attica, Greqi, e regjistruar në Regjistrin Tregtar të Shoqërive S.A të mbajtur pranë Prefekturës së Athinës, me numër regjistrimi 36581/01AT/B/96/446 dhe përfaqësuar nga Zëvendësdrejtori Z.Michail Tsamaz, rregullisht i autorizuar sipas kësaj Marrëveshjeje, në përputhje me vendimit e Këshillit të Administrimit të shoqërisë datë 294/4.2.2009

Në vijim referuar si "Kandidati Blerës" ose "Blerësi",

METE dhe Blerësi do t'i bëhet referim veçmas si "Pala" dhe bashkërisht si "Palët".

MEQENËSE:

a) "Albanian Mobile Communications" Sha (AMC) është një shoqëri aksionare e themeluar në bazë të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr.12910, datë 27.11.1995, më seli në Rruga "Gjergj Legisi", Laprakë, Tiranë, Shqipëri, dhe që ushtron aktivitetin e saj tregtar në sektorin e telekomunikacionit;

b) AMC ka një kapital të regjistruar prej 813.822.000,00 lekë, të ndarë në 813.822,00 aksione me vlerë nominale 1,000 lekë secila.

c) Pas privatizimit të 85% të aksioneve të AMC, METE si përfaqësuese e Republikës së Shqipërisë zotëron aktualisht 102.374 aksione të AMC-së (Aksionet), që përfaqësojnë 12.5792 % të kapitalit të AMC (Paketa shtetërore e aksioneve AMC).

d) Republika e Shqipërisë dëshiron të privatizojë paketën shtetërore të aksioneve AMC

dhe me qëllim tërheqjen e investitorëve strategjike sipas vendimit nr.410, datë 11.7.2007, Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë ka vendosur shitjen e paketës shtetërore të aksioneve AMC nëpërmjet ankandit publik;

e) METE, duke vepruar për llogari të Republikës së Shqipërisë, ka filluar procesin e shitjes së Aksioneve, në bazë të strategjisë se privatizimit, të miratuar nga ligji nr.8306, datë 14.3.1998 "Për strategjinë e privatizimit të sektorëve më rendësi të veçantë" dhe ligjit nr.8515, datë 21.7.1999 "Për privatizimin e shoqërisë anonime "Albanian Mobile Communications" sh.a." dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr.1402, datë 22.10.2008 "Për miratimin e rregullave të zhvillimit të ankandit publik për shitjen e paketës së aksioneve të "Albanian Mobile Communications" sh.a.-së, që ka mbetur pas transferimit të paketës tek investitorët strategjike, tek ish-pronaret e trualli dhe te punonjësit e kësaj shoqërie".

f) Kandidati blerës, nëpërmjet urdhrit të METE nr.117, datë 12.2.2009, sipas vendimit nr.4, datë 11.2.2009 të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave të ngritur me urdhrin e METE nr.899 datë 20.11.2008), është deklaruar si fituesi i procedurës se ankandit dhe plotëson kriteret për të lidhur këtë MSHA.

g) Palët kanë vendosur të lidhin këtë MSHA me qëllim përcaktimin e kushteve dhe afateve për të drejtat dhe detyrimet reciproke në lidhje me shitjen dhe blerjen e Paketës Shtetërore të Aksioneve AMC nga Shitësi tek Blerësi (Transaksioni).

ATËHERË, për sa më sipër Palët bien dakord si më poshtë:

1. PARASHTRIMET, PËRKUFIZIMET DHE INTERPRETIMI

1.1 Parashtrimet

Të gjitha parashtrimet e mësipërme janë pjesë përbërëse e kësaj Marrëveshje.

1.2 Përkufizimet

Përkufizimet e termave të kësaj Marrëveshjeje do të interpretohen në bazë të përkufizimeve të dhëna në shtojcën 1 të kësaj MSHA.

1.3 Interpretimi

Në këtë MSHA (duke përfshirë parashtrimet dhe shtojcat e saj), përveç kur kërkohet ndryshe nga konteksti ose kur është përcaktuar ndryshe në vijim:

a) referimet në nene janë referime në nenet e kësaj MSHA, dhe referimet në shtojca janë referimet në shtojcat e kësaj MSHA;

b) referimet ndaj një personi do të interpretohen duke përfshirë çdo individ, ndërmarrje, shoqëri, qeveri ose çdo ent tjetër të themeluar si person juridik të posaçëm dhe do të përfshijnë çdo trashëgimtar ose person të ceduar (nëpërmjet bashkimit ose ndryshe) të këtij entiteti;

c) referimet në oraret e ditës janë ato sipas orës në Tiranë;

d) referimet ndaj çdo dokumenti në "formën e rënë dakord" janë për dokumentet në formën e nënshkruar apo të firmosur (sigluar) nga ose në emër të Palëve për qëllime identifikimi;

e) gjatë llogaritjes së afateve brenda të cilave ose pas të cilave duhet të kryhet një veprim, data e cila i referohet ditës në fjale do të përjashtohet në këto llogaritje afatesh dhe nëse dita e fundit e këtyre afateve nuk është një dite pune, afati mbaron në ditën e punës pasardhëse;

f) numri njëjës do të përfshijë numrin shumës dhe anasjelltas;

g) titujt e neneve dhe shtojcave janë për lehtësi referimi dhe nuk ndikojnë në asnjë mënyrë në interpretimin e Marrëveshjes; dhe

h) çdo dokument bashkëngjitur kësaj MSHA-ja duke përfshirë edhe shtojcat është pjesë përbërëse e saj dhe do të ketë të njëjtën fuqi si të ishte përmendur shprehimisht në pjesën kryesore të kësaj MSHA dhe çdo referim në këtë MSHA do të përfshijë shtojcat e saj, si edhe çdo shtese tjetër të kësaj MSHA.

2. OBJEKTI I TRANSAKSIONIT

2.1 Shitja dhe blerja e aksioneve

Sipas afateve dhe kushteve të përcaktuara në këtë MSHA, Shitësi merr përsipër dhe i transferon Blerësit, duke garantuar plotësisht titullin e pronësisë, dhe Blerësi merr përsipër të blejë nga Shitësi të gjitha dhe jo më pak se të gjitha aksionet, dhe të paguajë çmimin e shitjes në

përputhje me parashikimin e nenit 3 të kësaj Marrëveshjeje.

2.2 Kalimi i pronësisë së ligjshme mbi aksionet

Kalimi i pronësisë së ligjshme mbi aksionet, të lira nga çdo barrë, nga Shitësi tek Blerësi, do të kryhet në datën e mbylljes, në përputhje me kushtet dhe afatet e kësaj Marrëveshjeje.

3. ÇMIMI I SHITJES

3.1 Çmimi

Në lidhje me shitjen e Aksioneve, Blerësi do t'i paguajë Shitësit shumën totale prej 48.200.000 euro (dyzet e tetë milionë e dyqind mijë euro.) (Çmimi i Shitjes).

Pagimi i çmimit të shitjes do të kryhet pa zbritur, kompensuar ose zvogëlime shume të çdo lloji dhe pa zbritur ose mbajtur taksa, tatime ose çdo pagesë tjetër shtetërore ose publike të detyrueshme sipas ligjeve e çdo juridiksioni sipas të cilit apo nëpërmjet të cilit kryhet kjo pagesë, përveç kur kjo zbritje tatimi ose tatim në burim kërkohet nga ligji. Nëse zbritja e tatimit ose tatimi në burim kërkohet me ligj të kryhet nga Shitësi, çmimi i shitjes do të zmadhohet me një shumë (pas zbritjes së tatimit ose tatimit në burim) të barabartë me shumën që do të paguhej nëse nuk do të ishte zbatuar tatimi ose tatimi në burim, të kërkuara për t'u kryer brenda afatit të lejuar dhe në shumën minimale të kërkuar nga ligji.

Çmimi i shitjes nuk do të përfshijë tarifat e regjistrimit ose të kalimit të pronësisë mbi aksionet, të cila do të paguhen plotësisht nga Blerësi.

Përveç sa parashikohet në paragrafët e mësipërm, shuma e çmimit të shitjes do të jetë shuma maksimale totale e çmimit që Blerësi do të paguajë për blerjen e paketës shtetërore të aksioneve AMC dhe Shitësi garanton se Blerësi nuk do të paguajë shuma të tjera përveç çmimit të shitjes.

3.2 Pagesa

Çmimi i shitjes që Blerësi do t'i paguajë Shitësit në datën e mbylljes do të jetë në euro, duke i dërguar Shitësit provën e SWIFT për transferimin e fondeve menjëherë të përdorshme në llogarinë bankare të mëposhtme (sipas ndryshimeve që mund të kryejë Shitësi në lidhje me këtë informacion):

Llogaria e çelur në: Banque de France, swift code BIC: BDFEFRPPCCT

Në emër të: numri i llogaris së bankës së Shqipërisë në Baque de France

IBAN FR7630001000640000005290032

Swift code bic: STANALTR

Sigurimi i ofertës do t'i kthehet Blerësit nga Shitësi, pasi çmimi i shitjes të depozitohet në llogarinë bankare të Shitësit sipas parashikimit të mësipërm.

Pavarësisht parashikimit të paragrafit të mësipërm, sigurimi i ofertës do t'i kthehet gjithashtu Blerësit nga Shitësi, nëse ndodhin ngjarjet e mëposhtme:

a) Neni 9.1 (Zgjidhja me Marrëveshje të Përbashkët); ose

b) Neni 9.3 (Zgjidhja nga Blerësi);

4. KUSHTET PARA MBYLLJES

Detyrimi i Blerësit për të blerë aksionet dhe detyrimi i Shitësit për të shitur aksionet sipas MSHA, i nënshtrohet dhe kushtëzohet nga përmbushja e kushteve të përcaktuara në nenin 4.1 dhe nenin 4.2 ose heqjes dorë me shkrim prej tyre brenda periudhës se parambylljes.

Secila Palë do të bëjë përpjekjet e saj më të mira për të përmbushur kushtet paraprake që janë në përgjegjësinë e vet dhe do të njoftojë Palën tjetër brenda afatit prej dyzet e pesë (45) ditë pune nga data e nënshkrimit (Periudha Parambylljes).

Kjo MSHA do të konsiderohet e pavlefshme dhe pa fuqi juridike nëse brenda periudhës së Parambylljes nuk janë përmbushur të gjitha kushtet paraprake, ose prej të cilave është hequr dorë me shkrim nga Pala e cila përfiton prej tyre.

Palët bien dakord se të gjitha veprimet që do të kryhen përpara datës së mbylljes do të konsiderohen si një transaksion i vetëm, në mënyrë që e drejta e zgjedhjes së Palës në interes të së

cilës është kryerja e një veprimi, mbyllja nuk do të ndodhë nëse dhe deri kur ky veprim të kryhet apo prej tij të hiqet dore nga Pala. Palët janë të ndërgjegjshme për natyrën thelbësore të këtij parashikimi.

4.1 Kushtet paraprake në përgjegjësinë e Shitësit

Detyrimi i Blerësit për të blerë dhe paguar aksionet në datën e mbylljes i nënshtrohet përmbushjes (ose heqjes dore nga Blerësi), brenda periudhës së parambylljes, të kushteve të mëposhtme të cilat Shitësi zotohet t'i përmbushë (Kushtet paraprake të Shitësit):

a) Shitësi duhet të përgatisë një vërtetim të nënshkruar nga Shitësi që konfirmon se të gjitha Garancitë e Shitësit janë të vërteta dhe të sakta në të gjitha aspektet thelbësore në datën e mbylljes, me të njëjtën fuqi e pasoja si në datën e nënshkrimit (me përjashtim të atyre garancive të Shitësit që kanë të bëjnë me çështje të një date të caktuar ose vetëm për një periudhë të caktuar kohe, e cila konsiderohet të jetë e vërtetë dhe e saktë në atë date ose në atë periudhe kohore);

b) Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë do të miratoje këtë MSHA dhe transaksionin e parashikuar në të, dhe Shitësi do të përgatisë një vërtetim rregullisht të nënshkruar nga Shitësi që konfirmon këtë miratim, në lidhje me numrin dhe datën e vendimit; dhe

c) Shitësi do të përgatisë një vërtetim të nënshkruar rregullisht nga Shitësi që vërteton se të gjitha kushtet paraprake në përgjegjësinë e Shitësit janë përmbushur.

Shitësi do të njoftojë me shkrim Blerësin se të gjitha kushtet paraprake në përgjegjësinë e tij janë përmbushur dhe Shitësi është gati të procedojë me mbylljen.

Kuptohet që kushtet paraprake të këtij nënparagrafi 4.1 janë vetëm në dobi të Blerësit dhe prej tyre Blerësi mund të heqë dorë në çdo kohë.

4.2 Kushtet paraprake në përgjegjësinë e Blerësit

Detyrimi i Shitësit për të shitur aksionet në datën e mbylljes i nënshtrohet përmbushjes (ose heqjes dorë nga Shitësi), brenda periudhës së Parambylljes, të kushteve të mëposhtme të cilat Blerësi zotohet t'i përmbushë (Kushtet Paraprake të Blerësit):

a) Blerësi do të përgatisë një vërtetim të nënshkruar rregullisht nga Blerësi që konfirmon se të gjitha Garancitë e Blerësit janë të vërteta dhe të sakta në të gjitha aspektet thelbësore në datën e mbylljes, me të njëjtën fuqi e pasoja si në datën e nënshkrimit (me përjashtim të atyre Garancive të Blerësit që kanë të bëjnë me çështje të një date të caktuar ose vetëm për një periudhë të caktuar kohe, e cila konsiderohet të jetë e vërtetë dhe e saktë në atë datë ose në atë periudhë kohore)

b) Blerësi do të marrë të gjitha autorizimet e nevojshme, duke përfshirë, nëse duhet, autorizimin nga Autoriteti Shqiptar i Konkurrencës në përputhje me ligjin, dhe çdo autorizim tjetër apo miratim të nevojshëm sipas legjislacionit shqiptar për të realizuar transaksionin e parashikuar në këtë Marrëveshje;

c) Blerësi do të përgatisë një kopje, me datën më të fundit, të dokumenteve të themelimit të shoqërisë dhe të gjithë vendimeve përkatëse të shoqërisë që autorizojnë Blerësin për të lidhur këtë MSHA dhe për të marrë përsipër detyrimet në përputhje më këtë MSHA, vendime këto që nuk janë revokuar; dhe

d) Blerësi do të përgatisë një vërtetim të nënshkruar rregullisht nga Blerësi që vërteton se të gjitha kushtet paraprake në përgjegjësinë e Blerësit janë përmbushur.

Blerësi do të njoftojë me shkrim Shitësin se të gjitha kushtet paraprake në përgjegjësinë e tij janë përmbushur dhe Blerësi është gati të procedojë me mbylljen.

Kuptohet që kushtet paraprake të këtij nënparagrafi 4.1 janë vetëm në dobi të Shitësit dhe prej tyre Shitësi mund të heqë dorë në çdo kohë.

5. ZOTIMET PARA MBYLLJES

5.1 Zotimet e Shitësit parambylljes

Para datës së mbylljes, Shitësi do të:

a) japë të gjithë ndihmën e kërkuar në mënyrë të arsyeshme nga Blerësi për të marrë autorizimet, sa më shpejt të jetë e mundshme pas datës se nënshkrimit;

b) mbajë aksionet të lira dhe nuk do t'i rëndojë ato me barrë.

5.2 Ushtrimi i së drejtës së aksionarëve të pakicës ndërmjet datës së nënshkrimit dhe datës së mbylljes

5.2.1 Deri në mbyllje Shitësi zotohet të ushtrojë të drejtat e votës në Asamblenë e Përgjithshme të AMC ose të nxisë anëtarët e emëruar nga ai në organet e administrimit të AMC (nëse ka) të veprojnë dhe votojnë në mënyrë që, në kufijtë e mundshëm, të mos shkaktojnë ose lejojnë që AMC të kryejë aktivitete ose transaksione që do të sillnin ose ka mundësi të sjellin një ndryshim material jo të favorshëm; dhe

5.2.2 Shitësi merr përsipër të njoftojë menjëherë Blerësin me shkrim nëse merr dijeni për (i) një ndryshim material jo të favorshëm dhe/ose (ii) çdo rrethanë të lindur deri në mbylljen e cila do të shkaktonte ose mund të shkaktonte shkeljen e ndonjërës nga zotimet e sipërpërmendura.

5.3 ZOTIMET E PËRBASHKËTA

5.3.1 Sipas afateve dhe kushteve të parashikuara në këtë Marrëveshje, Palët bien dakord të bashkëpunojnë dhe të bëjnë përpjekjet e tyre më të mira, të marrin ose nxisin kryerjen e të gjitha veprimeve të nevojshme, të duhura ose të këshillueshme sipas legjislacionit të zbatueshëm që të përmbushin dhe realizojnë transaksionin sipas MSHA.

6. MBYLLJA

6.1 Data dhe vendi i mbylljes

Mbyllja do të kryhet në Tiranë, Republika e Shqipërisë, në vendndodhjen e Shitësit, 5 ditë pune (Data e Mbylljes) pasi secila Palë të ketë njoftuar Palën tjetër, brenda periudhës së parambylljes, se të gjitha kushtet paraprake të përcaktuara në nenin 4 janë plotësuar ose është hequr dorë prej tyre.

Nëse për çdo arsye, mbyllja nuk mund të ndodhë në datën e mbylljes, Palët do të takohen sërish më datë 10 (dhjetë) Dite Pune më vonë, e cila do të konsiderohet si data e mbylljes dhe do të përpiqen sërish të procedojnë me mbylljen. Nëse mbyllja nuk ndodh edhe në këtë rast, Palët do të bëjnë përpjekjet më të mira për të arritur një marrëveshje me shkrim që parashikon masat për mbylljen e mëvonshme të transaksionit. Në rast se Palët nuk lidhin dot një marrëveshje të tillë brenda 15 (pesëmbëshjetë) ditë pune, MSHA do të konsiderohet automatikisht e zgjidhur pa cenuar të drejtat dhe detyrimet e Palëve në lidhje me këtë zgjidhje.

Transaksioni do të konsiderohet i mbyllur kur procedurat e përcaktuara në nenin 6.2 të jenë plotësuar në mënyrë të suksesshme.

6.2 Procedura e Mbylljes

Në datën e mbylljes ngjarjet e mëposhtme do të ndodhin sipas rendit të mëposhtëm:

1. Palët do të shkëmbejnë dokumentet dhe vërtetimet e përcaktuara në nenin 4;

2. Blerësi do t'i dorëzojë Shitësit një vërtetim të vlefshëm të nënshkruar nga Blerësi që konfirmon se Blerësi ka marrë rregullisht të gjitha autorizimet e nevojshme, duke përfshirë, nëse duhen, autorizimin nga Autoriteti Shqiptar i Konkurrencës për të zbatuar, në përputhje me ligjin, transaksionin e parashikuar në këtë Marrëveshje dhe kopje të këtyre Autorizimeve;

3. Shitësi do t'i dorëzojë Blerësit një kopje të vlefshme të vendimit të Këshillit të Ministrave që miraton MSHA dhe transaksionin e parashikuar në të;

4. Blerësi do të kryejë transfertën SWIFT të çmimit të shitjes në përputhje me nenin 3.2 dhe do t'i dorëzojë Shitësit prova të mjaftueshme të këtij transferimi;

5. Shitësi do t'i kthejë Blerësit sigurimin e ofertës dhe çdo e drejtë e Shitësit në lidhje më të do të konsiderohet e shuar;

6. Shitësi do t'i dorëzojë Blerësit një vërtetim të vlefshëm të nënshkruar nga Shitësi që konfirmon tjetërsimin e paketës shtetërore të aksioneve AMC tek Blerësi; dhe

7. Palët do të nënshkruajnë procesverbalin e mbylljes, duke konfirmuar se mbyllja ka ndodhur dhe Blerësi është pronari i ligjshëm i Paketës Shtetërore të Aksioneve AMC.

Shitësi, menjëherë pas Mbylljes, do të asistojë Blerësin në regjistrimin e aksioneve, gjatë procesit të depozitimit të dokumentacionit që provon tjetërsimin e pronësisë së Paketës Shtetërore të Aksioneve AMC nga Shitësi tek Blerësi dhe pagimin e çmimit të shitjes, në Regjistrin Tregtar

të mbajtur nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit.

6.3 Pasojat e mbylljes

Duke filluar nga data e mbylljes, Blerësi do të jetë pronar me të drejta të plota i aksioneve dhe nga ky moment do të ketë të drejta mbi çdo shpërndarje dividendi, përfitimesh, rezerve ose pasurie që ka të bëjë me Aksionet dhe në përgjithësi, të çdo dhe të gjitha shpërndarjet që do të vendosen, miratohen ose kryhen nga AMC ndaj aksionarëve të saj, nga data e mbylljes e në vijim. Blerësi do të ushtrojë nga ky moment të gjitha të drejtat që burojnë nga aksionet.

7. DEKLARIMET DHE GARANCITË

7.1 Deklarimet dhe garancitë e Blerësit

Në datën e nënshkrimit, Blerësi deklaron dhe garanton si më poshtë:

7.1.1 Statusi i shoqërisë

Blerësi është një shoqëri aksionare e themeluar sipas ligjit grek. Shoqëria është e organizuar në mënyrë të rregullt, ekziston ligjërisht dhe nuk është në gjendje falimentimi ose likuidimi në përputhje me ligjin e Greqisë dhe e regjistruar në Regjistrin Tregtar të Shoqërive S.A të mbajtur nga Prefektura e Athinës, me numër 36581/01AT/B/96/446.

7.1.2 Kompetencat dhe autoriteti i nevojshëm

Blerësi dhe përfaqësuesi(t) e tij gëzojnë (i) të drejtën dhe autoritetin e nevojshëm për të lidhur këtë MSHA dhe për të përmbushur detyrimet e përcaktuara në të dhe në çdo dokument tjetër për t'u nënshkruar në përputhje me këtë MSHA; (ii) çdo dhe të gjitha autorizimet nga shoqëria të kërkuara sipas legjislacionit në fuqi për zbatimin e MSHA janë marre dhe janë shpërndarë; (iii) MSHA dhe të gjitha dokumentet e tjera për t'u nënshkruar në lidhje me të dhe në të cilat Blerësi është Palë, përbejnë dhe do të përbëjnë kur të nënshkruhen, detyrime të Blerësit në përputhje me afatet e tyre.

7.1.3 Falimentimi dhe procedurat përkatëse

Blerësi (i) nuk i është ose nuk ka qenë nënshtruar procedurave për prishjen së shoqërisë, (ii) nuk është ose nuk ka qene ne gjendjen e paaftësisë paguese ose i paaftë për të shlyer detyrimet e tij në momentin që duhet të shlyhen; (iii) nuk është ose nuk ka qene subjekt kalimi apo marrëveshjeje të përgjithshme me ose në dobi të kreditorëve të tij, (iv) nuk i është ose nuk ka qenë nënshtruar procedurave të likuidimit dhe/ose falimentimit, (v) nuk ka miratuar vendime prishjeje ose likuidimi të shoqërisë dhe/ose (vi) nuk ka kërkuar ose nuk i është nënshtruar caktimit të administratorit të jashtëzakonshëm për shoqërinë ose kryesisht për të gjitha pasuritë e tij.

7.2 Deklarimet dhe garancitë e Shitësit

Në datën e nënshkrimit, Shitësi deklaron dhe garanton si më poshtë:

7.2.1 Statusi i shoqërisë

AMC është një shoqëri aksionare e themeluar sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë. Shoqëria është e organizuar dhe ekziston në mënyrë të rregullt, si edhe nuk është subjekt i procedurave të falimentimit dhe/ose likuidimit në përputhje me legjislacionin e Republikës së Shqipërisë.

7.2.2 Aksionet e parënduara me barrë

Aksionet përbëhen nga 102.374 (njëqind e dy mijë e treqindeshtatëdhjetë e katër) aksione, secila me të njëjtat të drejta dhe me vlere nominale prej 1,000 (një mijë) lekë secila. Aksionet janë emetuar në mënyrë të vlefshme, plotësisht të shlyera dhe të lira nga çdo barrë. Nuk ekziston asnjë marrëveshje ose detyrim për të krijuar ose vendosur barre në lidhje me aksionet. Asnjë person nuk ka pretenduar të ketë të drejtën të vendosë barrë në lidhje me aksionet.

7.2.3 Pronari i ligjshëm

METE është rregullisht i autorizuar për të vepruar për llogari të Republikës së Shqipërisë, e cila është pronari i ligjshëm i aksioneve të cilat përfaqësojnë dymbëdhjetë presje pesëmijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e dy për qind (12.5792%) të kapitalit aksionar të emetuar të AMC dhe të drejtave së votës. Shitësi gëzon të drejtën dhe autoritetin e plotë për të shitur, ceduar, kaluar aksionet në përputhje me kushtet dhe afatet e kësaj Marrëveshjeje.

Të gjitha aktet ligjore dhe/ose procedurat e tjera të ankandit të kërkuara nga ligji shqiptar për t'u kryer nga dhe për llogari të Shitësit, për të autorizuar këtë të fundit për të lidhur dhe zbatuar këtë Marrëveshje, janë kryer në mënyrë të rregullt, kjo Marrëveshje është lidhur dhe nënshkruar rregullisht nga Shitësi dhe përbën një detyrim të ligjshëm dhe të vlefshëm të Shitësit të zbatueshëm ndaj tij, në përputhje me kushtet dhe afatet e saj.

7.2.4 Licencat

Për sa është në dijeni Shitësi, (i) licencat janë në fuqi dhe janë të vlefshme, (ii) licencat janë lëshuar në përputhje me ligjet e zbatueshme dhe janë plotësisht të vlefshme e të detyruese dhe (iii) nuk ka ngjarje apo rrethanë që mund të ndikojë në vlefshmërinë ose të sjelle anulimin e licencave.

7.2.5 Falimentimi dhe procedurat përkatëse

Për sa është në dijeni Shitësi, (i) AMC nuk ka qenë subjekt i ndonjë procedure në kuadër të parandalimit dhe trajtimit të ndërmarrjeve në vështirësi (ose procedurave të ngjashme) ose të vendimit ose procedurave të prishjes dhe likuidimit të shoqërisë dhe nuk ka arsye për të cilat AMC mund të jetë subjekt i procedurave apo vendimeve të tilla dhe (ii) AMC nuk ndodhet në një periudhë të dyshimtë sipas legjislacionit mbi ekzekutimin e detyrueshëm dhe shlyerjes së detyrimeve në rruge gjyqësore.

7.2.6 Pajtueshmëria me ligjin

Për sa është në dijeni Shitësi, AMC kryen, nga data e themelimit të saj, aktivitetin e saj tregtar në përputhje të plotë me rregullat dhe legjislacionin në fuqi.

7.2.7 Pasqyrat financiare

Për sa është në dijeni Shitësi, të gjitha pasqyrat financiare të AMC nga themelimi i saj përfaqësojnë dhe janë në përputhje më pozitën e saj financiare dhe rezultatin e operacioneve të AMC në datat përkatëse dhe për periudhat e tyre të mbylljes e janë përgatitur në përputhje me Standardet Shqiptare të Kontabilitetit.

8. PRETENDIMET PËR DËMSHPËRBLIM

8.1 Përgjegjësia e Shitësit

Pas Mbylljes e në përputhje me parashikimet e MSHA dhe në mënyrë të veçantë të nenit 8, Shitësi do të dëmshpërbleje Blerësin për çdo dëm realisht të pësuar si rrjedhojë e drejtpërdrejtë e shkeljeve të çdo garancie të dhënë nga Shitësi sipas nenit 7.2.

8.2 Përgjegjësia e Blerësit

Nga mbyllja e në vijim, në përputhje me parashikimet e MSHA dhe më konkretisht këtij neni 8, Blerësi do të dëmshpërblejë (a) Shitësin për çdo dëm të shkaktuar aktualisht të ardhur si pasojë e drejtpërdrejtë e çdo shkeljeje të çdo garancie të dhënë nga Blerësi sipas nenit 7. 1.

8.3 Përjashtimet dhe kufizimet e përgjegjësisë së Shitësit

Pavarësisht çdo parashikimi tjetër të MSHA, Shitësi nuk do të jetë përgjegjës sipas MSHA.

8.3.1 Afatet

Me përjashtim të rastit të pretendimit për shkelje të çdo garancie të Shitësit, Blerësi i dërgon Shitësit një njoftim ankimi brenda dy (2) vjetësh nga data e mbylljes;

8.3.2 Kufiri maksimal i pretendimeve

(i) në lidhje me çdo pretendim të ngritur për shkelje të çdo garancie që parashikon neni 7.2.1 (Statusi i Shoqërisë), neni 7.2.2 (Aksionet e pa rënduara me barrë) dhe neni 7.2.3 (Pronari i ligjshëm), të paguajë çdo shume që në vlerën totale tejkalon 100% të çmimit të shitjes; (ii) në përputhje me çdo pretendim të ngritur për shkelje të çdo garancie që përmban neni 7.2 të

ndryshme nga garancitë e referuara ne piken (i) më sipër, të paguajë çdo shumë që në vlerën totale tejkalon 20% të çmimit të shitjes;

8.3.3 Njoftimet

në lidhje me çdo pretendim kur arsyeja e këtij pretendimi është bërë e ditur në mënyrë të posaçme dhe të drejtë nga Shitësi Blerësit të paktën pesë (5) ditë pune përpara 10 shkurt 2009 në këtë MSHA dhe shtojcat e saj dhe përgjithësisht për çdo të dhënë;

8.3.4. Neglizhenca e Blerësit

në lidhje me çdo dëm nëse ky dëm nuk do të kishte ndodhur përveç:

a) neglizhencës ose sjelljes së pakujdesshme të Blerësit pas mbylljes;

b) ndryshimeve në mbajtjen e kontabilitetit: çdo ndryshim në politikat kontabël, bazat ose praktikat e Blerësit, të vendosura ose me fuqi pas mbylljes;

8.3.5 Fitimi neto

në lidhje me çdo pretendim për dëme të shkaktuara Blerësit në kufijtë e çdo përfitimi që i korrespondon përfitimit neto të Blerësit të lindur prej saj.

8.3.6 Pranimet e Blerësit

Blerësi njeh dhe bie dakord se (me përjashtim të garancive të shprehura të Shitësit që përmban kjo MSHA):

i) Blerësi nuk është detyruar të lidhë këtë MSHA mbështetur në ndonjë deklarim, garanci, zotim, kuptim ose çfarëdo deklarate gojore të kryer nga Shitësi, agjentët, personeli ose këshilltarë e tij, të ndryshme nga ato shprehimisht të referuara në këtë MSHA;

ii) Blerësi ishte përgjegjës i vetëm për zhvillimin e hetimit të vet të pavarur dhe të *due diligence*, me shpenzimet e veta, përpara lidhjes së kësaj MSHA;

iii) Blerësi ka marrë të gjitha këshillat e nevojshme të pavarura sipas kërkesave të veta dhe ka blerë aksionet duke përballuar rrezikun e tij; dhe

iv) Blerësi ka akses të plote në çdo të dhënë dhe çdo informacion të përmbajtur në *data-room* e Shitësi nuk mban përgjegjësi në lidhje me plotësinë ose saktësinë e informacionit të përmbajtur në *data-room*.

Shitësi nuk do të mbajë përgjegjësi për pretendimet në lidhje me të dhënat dhe çdo informacion të përmbajtur në *data-room* të ndryshëm nga pretendimi në lidhje me garancitë e shprehura në këtë MSHA.

8.4 Përjashtimi dhe kufizimet e përgjegjësisë së Blerësit

Pavarësisht çdo parashikimi tjetër të MSHA, Shitësi nuk do të jete përgjegjës sipas MSHA:

8.4.1 Afatet

Nëse një njoftim ankimi është paraqitur nga Shitësi tek Blerësi pas dy (2) viteve nga data e mbylljes, me përjashtim të rasteve të një pretendimi të ngritur për shkelje të çdo garancie nga Blerësi;

8.4.2 Kufiri maksimal i pretendimeve

Çdo pretendim nuk do të tejkalojë shumën e përgjithshme të barabartë me 20% të çmimit të shitjes (me përjashtim të pretendimeve në lidhje me mospagimin e Çmimit të Shitjes);

8.4.3 Neglizhenca e Shitësit

Pretendimet për dëme nëse dëmi është shkaktuar nga neglizhenca dhe/ose sjellja e pakujdesshme e Shitësit;

8.4.4 Fitimi neto

Pretendimet për dëmet e pësuara nga Shitësi në kufijtë e përfitimit neto përkatës të arritur nga Shitësi.

8.5 Zvogëlimi i dëmeve

Të dyja Palët do të mundësojnë që të gjitha hapat e nevojshëm të jenë ndërmarrë dhe e gjithë ndihma e nevojshme të jetë dhënë për të shmangur ose zvogëluar çdo dëm i cili në mungesë të zvogëlimit mund të shkaktojë lindjen e përgjegjësisë në lidhje me çdo pretendim sipas

kësaj MSHA.

8.6 Përcjellja e pretendimeve

8.6.1 Njoftimet

Nëse Blerësi njihet me çdo arsye që mund të përbëjë shkas për ngritje pretendimi ndaj Shitësit sipas kësaj MSHA, një njoftim për këtë fakt duhet t'i dërgohet Shitësit sa më shpejt të jetë e mundur dhe brenda tre (3) muajve nga zbulimi i këtij fakti nga Blerësi.

Çdo pretendim për dëme sipas nenit 8 do të verifikohet duke i dhënë Shitësit një njoftim me shkrim për pretendimin në fjalë, duke specifikuar (me detaje të arsyeshme) çështjen e cila ka bërë të lindë pretendimi, llojin e pretendimit dhe shumën e kërkuar në lidhje me të (duke përcaktuar me detaje të arsyeshme, llogaritjet e pretenduesit në lidhje më humbjet që supozohet të jenë shkaktuar prej saj), dhe një njoftim i tillë do të jetë një "Njoftim ankimi".

8.6.2 Hetimet nga Shitësi

Pa përjashtuar vlefshmërinë e pretendimit ose supozimit të pretendimit në fjalë, Shitësi dhe këshilltarëve të tij profesionistë do t'u jepet koha dhe burimet e mjaftueshme për të hetuar çështjen ose rrethanat e supozuara që kanë mundësuar lindjen e pretendimit në fjalë dhe shumën që duhet shlyer. Për këtë qëllim Blerësi duhet t'i japë t'i siguroje Shitësit: (i) të gjithë këtë informacion dhe ndihmë të kërkuar dhe (ii) të drejtën për të shqyrtuar dhe bërë kopje ose fotografi të çdo dokumenti dhe regjistrimi, në kufijtë e arsyeshëm që lidhen me çështjen e pretenduar dhe sipas kërkesave të arsyeshme të Shitësit apo të këshilltarëve të tij profesionistë. Shitësi bie dakord të mbajë të gjithë këtë informacion konfidencial dhe ta përdorë vetëm për qëllimet e pretendimit në fjalë. Nëse pretendimi do të konsiderohet i pabazuar, Blerësi do të dëmshpërblejë plotësisht Shitësin për çdo shpenzim të kryer në lidhje me rrëzimin e pretendimit.

8.6.3 Pretendimet/përgjegjësia e palëve të treta

Nëse pretendimi në fjalë është rezultat ose ka lidhje me një pretendim ose përgjegjësi të një pale të tretë, atëherë:

a) nuk do të pranohet përgjegjësia nga ose për llogari të Blerësit dhe pretendimi nuk do të cenohet, zgjidhet ose paguhet pa miratimin paraprak me shkrim të Shitësit, miratimi i të cilit nuk do të refuzohet ose shtyhet pa arsye; dhe

b) Shitësi do të gëzojë të drejtën të marrë pjesë me shpenzimet dhe këshillimet e zgjedhura vetë në mbrojtje të Blerësit ndaj pretendimeve të palës së tretë. Në një rast të tillë, Blerësi do t'i japë Shitësit dhe këshilltarit të tij mundësinë për të diskutuar dhe kundërshtuar (e drejtë kjo që nuk duhet ushtruar në mënyrë të paarsyeshme) në lidhje me drejtimin e mbrojtjes se pretendimit. Blerësi duhet të mbajë të informuar Shitësin, në mënyrë të arsyeshme, në lidhje me ecurinë e pretendimit të palëve të treta dhe mbrojtjen përkatëse dhe do të jetë i gatshëm t'i sigurojë Shitësit kopje së të gjithë njoftimeve, komunikimeve me shkrim dhe dosjeve (duke përfshirë edhe dokumentet gjyqësore) të përgatitura nga ose për llogari të secilës palë të pretendimit në fjalë. Shitësi do të ruajë konfidencialitetin e këtij informacioni.

8.7 Shlyerja paraprake

Nëse përpara se Shitësi të paguajë shuma për shlyerjen e pretendimeve sipas kësaj MSHA, Blerësi përfiton ose është gëzon të drejtën të përfitojë (me anë të pagesës, zbritjes, kreditimit, përjashtimit ose mjeti tjetër) nga pala e tretë një shumë e cila i referohet shumës së ngjarjes së pretenduar, Blerësi do të mundësojë kryerjen e të gjitha hapave të nevojshme të ndërmerren për mbledhjen e kësaj shume dhe çdo shumë e shlyer në këtë mënyrë (pa përfshirë kostot e arsyeshme të kryera për këtë shumë dhe tatimin përkatës pas llogaritjes së çdo lehtësire tatimore të mundshme në lidhje me çështjen për të cilën ka lindur pretendimi) do të zvogëlojë ose kënaqë, sipas rastit, këtë pretendim duke kuptuar që (a) Blerësi do të njoftojë për këtë pretendim Shitësin sipas kësaj MSHA në përputhje me kohën në të cilën ka ndodhur ngjarja që i ka dhënë shkas pretendimit dhe përpara ekzekutimit për mbledhjen e shumës nga palët e treta dhe (b) në rast se ky njoftim pretendimi është dhënë brenda afatit të përcaktuar në nenin 8.3.1, ky pretendim do të ngrihet dhe mund të ekzekutohet nga Shitësi vetëm pasi të jenë kryer të gjithë hapat e nevojshme për të ekzekutuar mbledhjen e kësaj shume, pasi të jenë zbritur shumat e shlyera në

atë moment (siç parashikohet më sipër).

8.8 Shlyerja e mëpasshme

Nëse Shitësi paguan një shumë për të shlyer pretendime sipas kësaj MSHA dhe Blerësi perfiton (nëpërmjet pagesës, zbritjes, kreditimit, përjashtimit ose tjetër) nga një palë e tretë një shumë e cila i referohet çështjes së pretendimit në fjale, shume e cila nuk do të ishte përfituar në mënyrë të ndryshme nga Blerësi, ky i fundit do t'i paguajë Shitësit një shumë të barabartë me (i) shumën e shlyer nga pala e tretë pa përfshirë shpenzimet dhe kostot e arsyeshme të kryera për përfitimin e kësaj shume dhe tatimet e zbatueshme mbi këtë shumë duke konsideruar lehtësirat tatimore në lidhje më çështjen që ka bërë të lindë pretendimi ose (ii) nëse është me e vogël, shumën e paguar paraprakisht nga Shitësi Blerësit duke përjashtuar tatimet e zbatueshme për këtë shumë.

8.9 Tatimet

Në llogaritjen e përgjegjësisë së Shitësit për shkelje të kësaj MSHA, do të konsiderohet shuma (nëse ka) nga e cila çdo tatim për të cilin Blerësi do të ishte përgjegjës është zvogëluar ose hequr si pasojë e çështjes nga e cila ka lindur kjo përgjegjësi ose rishlyerje e tatimeve mbi çështjen nga e cila ka lindur kjo përgjegjësi.

8.10 Pagesa

Pagesa e çdo shume që duhet t'i paguhet Blerësit nga Shitësi sipas nenit 8 do të kryhet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data në të cilën shuma e përgjegjësisë së Shitësit do të përcaktohet në mënyrë përfundimtare nëpërmjet një marrëveshjeje miqësore ndërmjet Palëve ose një vendimi të detyrueshëm të Gjykatës se Arbitrazhit.

8.11 Të gjitha pretendimet për t'u zgjidhur sipas nenit 12

Çdo dhe të gjitha pretendimet për dëme të lindura nga ose në lidhje me këtë MSHA do të zgjidhen në përputhje me nenin 12 të mëposhtëm.

9. ZGJIDHJA

9.1 Zgjidhja me Marrëveshje të përbashkët

9.1.1 Kjo MSHA mund të zgjidhet dhe të hiqet dorë nga transaksioni në çdo kohë me marrëveshje të përbashkët me shkrim të Shitësit dhe Blerësit, përpara datës së mbylljes.

9.1.2 Palët bien dakord që kjo MSHA do të zgjidhet dhe do të hiqet dore nga Transaksioni pa përgjegjësi të Palëve për shpenzime ndaj Palës tjetër në rast se kushtet paraprake të përcaktuara në nenin 4.2. (b) nuk janë plotësuar nga Blerësi brenda periudhës së parambylljes, me kusht që Blerësi të ketë kryer në kohë të gjitha aplikimet dhe njoftimet dhe ka depozituar pranë autoriteteve të gjithë informacionin dhe dokumentet e kërkuara nga ligji, dhe kushtet paraprake nuk janë realizuar për arsye të ndryshme nga moskryerja, mosplotësimi, pakujdesia ose neglizhenca me dashje e Blerësit plotësimin e kërkesave të nevojshme. Në raste të tilla Blerësi do të njoftojë Shitësin në lidhje me këtë pamundësi dhe Shitësi nuk do të refuzojë në mënyrë të paarsyeshme miratimin e tij për zgjidhjen e përbashkët të Marrëveshjes bazuar në këto rrethana.

9.2 Zgjidhja nga Shitësi

Kjo MSHA mund të zgjidhet nga Shitësi pas njoftimit me shkrim të Blerësit, në çdo kohë para mbylljes:

a) nëse një kusht paraprak në përgjegjësinë e Blerësit (siç përcaktohet në nenin 4.2) nuk është përmbushur ose prej të cilit është hequr dorë me shkrim nga Shitësi brenda periudhës se parambylljes ose nëse ka shkelje nga Blerësi të detyrimeve të tij sipas kësaj MSHA në datën mbylljes ose përpara saj;

b) nëse shitja e aksioneve nuk është përfunduar në datën e mbylljes (ose në një datë të mëvonshme për të cilën Palët kanë rënë dakord me shkrim) si pasojë e moskryerjes, pakujdesisë ose heqjes dorë nga Blerësi;

c) nëse një likuidues ose nëpunës i ngjashëm është caktuar për të gjithë ose në thelb për të gjithë pasurinë ose sipërmarrjet e Blerësit ose është dhënë/marrë një urdhër ose vendim gjykate për prishjen e Blerësit ose është paraqitur kërkesa për paaftësinë paguese të Blerësit; ose

d) në rastin e një mospërmbushjeje të Garancive të Blerësit, si më sipër në nenin 7.1, nga

Blerësi dhe me kusht që një shkelje e tillë nuk është eliminuar nga Blerësi brenda 20 ditë pune pas njoftimit me shkrim të Shitësit.

9.3 Zgjidhja nga Blerësi

Kjo MSHA mund të zgjidhet nga Blerësi pas njoftimit më shkrim dërguar Shitësit, në çdo kohe para datës së mbylljes:

a) nëse një kusht paraprak në përgjegjësinë e Shitësit (siç përcaktohet në nenin 4.1) nuk është përmbushur ose prej të cilit është hequr dorë me shkrim nga Blerësi brenda periudhës se parambylljes ose nëse ka shkelje nga Shitësi të detyrimeve të tij sipas kësaj MSHA në ose përpara mbylljes;

b) nëse shitja e aksioneve nuk është përfunduar në datën e mbylljes (ose në një date të mëvonshme për të cilën Palët kane rënë dakord me shkrim) si pasoje e moskryerjes, pakujdesisë ose heqjes dorë nga Shitësi;

c) në rast shkelje materiale të zotimeve të Shitësit sipas nenit 5.1, dhe/ose një shkelje materiale e zotimeve sipas nenit 5.2 dhe 5.3, të cilat shkaktojnë një ndryshim material të jo të favorshëm; ose

d) në rastin e një mospërmbushje të garancive të Shitësit, si më sipër në nenin 7.2, neni 7.2.1. (statusi i shoqërisë), neni 7.2.2. (aksionet e parënduara me barrë), neni 7.2.3. (pronari i ligjshëm) nga Shitësi dhe me kusht që një shkelje e tillë nuk është eliminuar nga Shitësi brenda 20 ditë pune nga njoftimi me shkrim i Blerësit.

9.4 Mjete të tjera

E drejta e Palëve për të zgjidhur këtë MSHA sipas këtij neni 9 nuk do të cenojë asnjë të drejtë, detyrim ose përgjegjësi ose mjete ne dispozicion te Palëve sipas kësaj MSHA.

10. KONFIDENCIALITETI

Secila nga Palët e kësaj Marrëveshjeje merr përsipër të bëjë të ditur, përhapë ose komunikojë informacione në lidhje me aktivitetin tregtar të AMC që në atë kohë nuk janë të njohura nga publiku (duke përfshirë detajet e kësaj Marrëveshjeje) dhe nuk janë bërë të njohura si pasojë e shkeljes se parashikimeve të kësaj Marrëveshje (Informacioni Konfidencial). Gjithashtu, secila Palë merr përsipër të mos përdorë Informacionin Konfidencial për qëllime përfitimi vetjake ose të palëve të treta ose të lejojë apo ndihmojë, nëpërmjet miratimit të heshtur ose mënyra të tjera, palë të treta të përdorin informacionin konfidencial në mënyra të ndryshme (i) për aq sa është e nevojshme për ekzekutimin e të drejtave ose për të përmbushur detyrimet e saj sipas kësaj MSHA, (ii) nga kërkesat e ligjit, administrative ose rregulloret e bursave që zbatohen ndaj një Pale dhe çdo aksionari të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të kësaj Pale.

Parashikimet e këtij Neni 10 i shtohen, dhe nuk zëvendësojnë marrëveshje konfidencialiteti të lidhur më parë ndërmjet Palëve në lidhje më këtë transaksion.

11. SHPALLJET

11.1 Shpalljet e ndaluara

Sipas nenit 11.2, asnjë Palë nuk do të bëjë ose lëshojë në asnjë moment (si përpara, ashtu edhe pas mbylljes) njoftime, qarkore ose publikime te tjera lidhur me çështje të referuar në këtë MSHA pa marrë më parë miratimin me shkrim të Palës tjetër në lidhje me formën dhe përmbajtjen e shpalljes. Ky detyrim do të jetë në fuqi për një periudhe prej 3 (tre) muajsh nga data e mbylljes.

11.2 Shpalljet e lejuara

Neni 11.1 nuk do të zbatohet ndaj shpalljeve, qarkoreve ose publikimeve të tjera:

a) të kërkuara nga ligji i çdo juridiksioni kompetent ose nga rregulla apo rregullore të çdo organi qeveritar ose rregullues. Në një rast të tillë, Pala që bën ose dërgon shpalljen, qarkoren apo publikimin duhet, për aq sa është e zbatueshme, të informojë më parë Palët e tjera mbi formën dhe përmbajtjen e kësaj shpallje;

b) të bëra nga Shitësi në media si pjesë e detyrimit të tij të përgjithshëm për të informuar publikun mbi çështje të interesit publik të tilla si emri i Blerësit dhe procesi i privatizimit; ose

c) e cila është në një formë për të cilën Palët kane rënë dakord sipas nenit 11.1 të

mësipërm, ose është dërguar nga ose për llogari të Blerësit pas mbylljes duke lajmëruar mediat, punëmarrësit, klientët, furnitorët ose agjentët e AMC mbi transaksionin.

12. LIGJI I ZBATUESHËM DHE ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

Palët bien dakord se çdo mosmarrëveshje (përfshirë pretendimet për dëme sipas nenit 8 të kësaj MSHA) ndërmjet disa ose të gjithë Palëve dhe që lindin nga ose në lidhje me këtë MSHA do të zgjidhen në përputhje me parashikimet e nenit 12.

12.1 Ligji i zbatueshëm

Kjo MSHA rregullohet dhe interpretohet në përputhje me ligjet dhe çdo akt tjetër që ka fuqinë e ligjit të Republikës së Shqipërisë.

12.2 Zgjidhjet miqësore

Secila Palë do të përpiqet të zgjidhë në mirëbesim dhe me kujdesin e arsyeshëm çdo mosmarrëveshje ndërmjet disa ose të gjitha Palëve që lindin nga ose kanë lidhje me këtë MSHA.

12.3 Arbitrazhi

Në përputhje me nenin 12.2, të gjitha mosmarrëveshjet e lindura nga ose që kanë lidhje me këtë MSHA të pazgjidhura miqësisht nga Palët brenda 30 ditëve do të dërgohen nga secila ose të dyja Palët për arbitrim dhe do të zgjidhen në mënyrë përfundimtare sipas Rregullave të Arbitrazhit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë (Rregullat e ICC) nga 3 arbitra (Gjykata e Arbitrazhit) të caktuar në përputhje më rregulloren e ICC.

Brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga konfirmimi i tyre, arbitrat e caktuar nga Palët do të caktojnë së bashku Kryetarin e Gjykatës se Arbitrazhit për t'u miratuar nga Gjykata Ndërkombëtare e Arbitrazhit. Nëse ky emërim dështon, Kryetari i Gjykatës se Arbitrazhit do të caktohet në përputhje me rregulloren e ICC.

Procedurat e arbitrazhit do të kryhen në qytetin e Parisit, Francë. Procedurat e arbitrazhit do të zhvillohen në gjuhën angleze.

13. TË NDRYSHME

13.1 Njoftimet

Të gjitha komunikimet, njoftimet dhe lajmërimet e kërkuara apo lejuara nga kjo MSHA do të kryhen me shkrim në gjuhen angleze dhe do të dorëzohen dorazi, me letërporosi me kthim përgjigje nëpërmjet shërbimit postar 24 orë që siguron provë të dërgesës ose kopje, në adresat e mëposhtme, me përjashtim të dhe deri kur njëra nga Palët të njoftojë Palën tjetër në përputhje me këtë nen 13.1 për një ndryshim të adresës:

Për Shitësin: Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Blvd. "Dëshmorët e Kombit", nr.2, Tiranë, Shqipëri.

Për Blerësin: Cosmote Mobile Telecommunication S.A, 44. Kiffisias Ave. Marousi Attica Greece

Në vëmendje të: Z.Evrikos Sarsentis

Bussines Performance&Development Director

13.2 Shpenzimet

Secila nga Palët do të përballojë shpenzimet e kryera në lidhje me negocimin, lidhjen e Marrëveshjes dhe mbylljen e dokumentacionit ligjërisht të detyrueshëm për shitjen dhe blerjen.

Çdo kalim, regjistrim dhe/ose detyrim pulle dhe/ose taksash për t'u paguar si pasojë e nënshkrimit të kësaj MSHA dhe kalimit të aksioneve do të paguhet nga Blerësi.

13.3 Marrëveshja e plotë

Kjo MSHA (së bashku me të gjitha dokumentet e referuara në të ose të nënshkruara përpara mbylljes) përbën Marrëveshjen dhe mirëkuptimin e plotë ndërmjet Palëve në lidhje me objektin e saj dhe zëvendëson e ka përparësi ndaj të gjitha kontratave, marrëveshjeve ose angazhimeve të mëparshme në lidhje me objektin në fjalë.

13.4 Ndryshimet

Asnjë ndryshim i kësaj MSHA nuk do të jetë i vlefshëm nëse nuk kryhet me shkrim dhe nënshkruhet nga Palët.

13.5 Cedimi

Kjo MSHA do të jetë e detyrueshme dhe do të ketë pasoja juridike ndaj Palëve, trashëgimtareve të tyre, si dhe ndaj atyre të cilëve iu është cedуar në mënyrë të rregullt.

13.6 Pavlefshmëria e pjesshme

Nëse pjese të kësaj MSHA janë ose bëhen të pavlefshme ose jodetyruese, Palët do te jenë të detyruara të zbatojnë pjesën tjetër të Marrëveshjes. Palët përkatëse do të zëvendësojnë në këtë rast pjesën e pavlefshme ose jo detyruese me parashikime të vlefshme e detyruese dhe fuqia e të cilave, sipas përmbajtjes dhe qëllimeve të kësaj MSHA, është sa më shume të jete e mundur e ngjashme me pjesën e pavlefshme ose jodetyruese.

13.7 Heqja dorë nga imuniteti sovran

Shitësi deklaron dhe garanton se lidhja nga ana e tij e kësaj MSHA dhe përmbushja e detyrimeve të tij të parashikuara në këtë Marrëveshje janë akte tregtare dhe jo akte publike ose qeveritare dhe Shitësi nuk ka të drejte të pretendojë imunitetin e tij nga procedurat ligjore ose pasuritë e tij për shkak të sovranitetit ose ndryshe në baze të ligjit apo çdo juridiksioni në të cilin një veprim mund të sjellë ekzekutimin e detyrimeve të lindura nga ose në lidhje me këtë MSHA. Për aq sa Shitësi ose pasuri të tij gëzojnë ose në vijim mund të përfitojnë të drejte imuniteti nga ankimi, procedurat ligjore, sigurim padie përpara gjykimit, masa të tjera ose ekzekutime vendimesh për shkak të sovranitetit ose arsye tjetër, Shitësi zotohet në mënyrë të parevokueshme të heqë dore nga këto të drejta imuniteti në lidhje me detyrimet e lindura nga ose që kanë të bëjnë me këtë MSHA.

13.8 Heqja dorë

Çdo dorëheqje nga njëra Palë për të ushtruar një ose më shumë të drejta që i janë dhënë nga ose në zbatim të kësaj Marrëveshjeje nuk do të interpretohen si dorëheqje përfundimtare dhe e përhershme nga ushtrimi i këtyre të drejtave.

13.9 Garanci të mëtejshme

Secila nga Palët e kësaj Marrëveshjeje do të kryeje këto veprime të mëtejshme dhe do të nënshkruajë dokumente të tjera të nevojshme për të kryer e dhëne fuqi të plote parashikimeve të kësaj MSHA dhe qëllimeve të Palëve të pasqyruara në të.

13.10 Monedha

Përveç rastit kur parashikohet ndryshe, çdo dhe të gjitha pagesat në lidhje me këtë Marrëveshje do të kryhen në euro.

13.11 Gjuha

Kjo MSHA hartohet në gjuhën angleze dhe një përkthim ztrtar në gjuhën shqipe. Në rast mospërputhjeje ndërmjet dy versioneve gjuhësore, versioni anglisht do të ketë përparësi.

Lidhur në Tiranë, Shqipëri më 5 mars 2009 në 4 (katër) kopje origjinale nga:

SHTOJCAT

SHTOJCA 1

PËRKUFIZIMET

Në këtë MSHA (duke përfshirë parashtrimet dhe shtojcat e saj), përveç kur është ndryshe nga konteksti ose kur është përcaktuar ndryshe në vijim, fjalët e mëposhtme do të kenë këto kuptime:

"Marrëveshje" do të kuptohet kjo marrëveshje duke përfshirë shtojcat e saj;

"Autoriteti Shqiptar i Konkurrencës" do të kuptohet Komisioni i Konkurrencës i parashikuar në nenin 19 të ligjit shqiptar nr.9121, datë 28 korrik 2003;

"Gjykate Arbitrazhi" do të ketë kuptimin e përcaktuar në nenin 12.3;

"Autorizim" do të kuptohen autorizimet, lejet, licencat, miratimet dhe deklarimet dhe moskundërshtimet e deklarimeve, të kërkuara nga Kandidati Blerës për zbatimin e transaksionit;

“Sigurimi i ofertës” do të kuptohet letër kredi (letter of credit) e lëshuar nga banka për të siguruar ofertën e kandidatit Blerës në ankandin e privatizimit të Paketës Shtetërore të Aksioneve AMC;

"Ditë pune" do të kuptohet çdo dite kalendarike e ndryshme nga e shtuna dhe e diela dhe çdo ditë tjetër në të cilën bankat nuk janë të hapura për kryerjen e aktivitetit të zakonshëm në Tiranë, Shqipëri;

"Njoftim ankimi" do të ketë kuptimin e përcaktuar në nenin 8.6.1;

"Mbyllje" do të kuptohet mbyllja e shitjes dhe blerjes së aksioneve sipas kësaj Marrëveshjeje nëpërmjet përmbushjes së detyrimeve përkatëse të Palëve;

"Data e mbylljes" do të kuptohet data e përcaktuar në nenin 6.1;

"Kushtet paraprake" do të kuptohen kushtet paraprak të Blerësit dhe kushtet paraprake të Shitësit që duhet të plotësohen me qëllim që të ndodhë mbyllja sipas parashikimeve të nenit 4;

"Dëme" i referohet çdo dëmi të drejtpërdrejtë financiar që vjen si pasojë e shkeljes së deklarimeve dhe/ose garancive, përfshirë shpenzimet e arsyeshme të kryera për të parandaluar shkaktimin e këtij dëmi;

"Të dhëna" do të kuptohet çdo informacion, në kopje të shkruar ose format dixhital, që i sigurohet ose mundësohet Blerësit ose agjenteve të tij, personave të caktuar prej tij apo këshilltarëve të Shitësit, në lidhje me transaksionin e parashikuar në këtë MSHA, përfshirë edhe memorandumin informativ dhënë Blerësit;

"Barrë" do të kuptohet çdo interes ose kapital i çdo personi (duke përfshirë çdo të drejtë për të blerë, opsioni riblerjeje ose të drejte parablerjeje) apo çdo barrë hipotekore, kufizim, peng, privilegj, barrë siguruese (përfshirë ato të krijuara me ligj), posedim titulli ose marrëveshje të tjera siguruese apo marrëveshje të tjera, qira, blerje me këste, shitje me kredi ose marrëveshje të tjera për shlyerjen me këste;

"Ligj" do të kuptohet çdo akt i zbatueshëm kombëtar ose vendor, dekret, urdhër ose ligje të tjera (duke përfshirë dhe ligjin mbi ambientin), rregullore ose statut apo çdo rregull, kod ose direktivë ose licencë, pëlqim, leje, autorizim apo miratim tjetër i Republikës së Shqipërisë ose ndarje administrative të saj ose çdo personi juridik shtetëror (të pavarur ose jo) që gëzon juridiksionin e duhur, në kufijtë e publikimit dhe aksesit publik, vendime të gjykatave të ndryshme dhe komisioneve gjyqësore të Republikës së Shqipërisë, vendime ministrash, qarkore departamentesh, si edhe prononcime dhe interpretime nga organe zyrtare të Republikës së Shqipërisë që kanë juridiksion mbi çështjen në fjale; sipas ndryshimeve të here pas hershme;

"Licencë" do të kuptohet liçenca e telefonisë celulare GSM, licenca ISP, licenca e transmetimit të të dhënave dhe çdo licencë tjetër e marrë nga rregullatori për kryerjen e aktivitetit tregtar të AMC;

"Ndryshime materiale jo të favorshme" do të kuptohet çdo ngjarje e ndodhur gjatë periudhës se parambylljes që shkakton ose mund të shkaktojë në mënyrë të arsyeshme një ndryshim të jo të favorshëm material të aktivitetit tregtar dhe pasurive të AMC, duke përfshirë, por pa u kufizuar në: (i) dorëheqjen, anulimin ose ndryshimin e një licence ose (ii) deklarimin e paaftësisë paguese për likuidimin e AMC nga gjykata kompetente;

"Qendra Kombëtare e Regjistrimit " do të kuptohet organi administrativë i themeluar sipas ligjit nr.9723, datë 3.4.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit ";

"Person" do të kuptohet çdo person fizik, shoqëri aksionare, shoqëri më përgjegjësi të kufizuar, bashkëpunim, bashkim shoqërish, fondacion, trust ose ente të tjera ose organizata që gëzojnë personalitet juridik, duke përfshirë Autoritetet Shtetërore;

"Periudha e Parambylljes" do të ketë kuptimin e caktuar në nenin 4. Parambyllja nuk përfshin datën e nënshkrimit;

"Çmimi i shitjes" do të ketë kuptimin e përcaktuar në nenin 3.1;

"Rregullator" do të kuptohet Autoriteti Shqiptar i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) ose çdo ent tjetër rregullator në industrinë e telekomunikacionit apo departament tjetër rregullator, organ, agjenci ose autoritet i Republikës së Shqipërisë ose njësi administrative të krijuara në baze të ligjeve të zbatueshme në Republikën e Shqipërisë, që ka autoritetin të miratojë tarifat dhe çmimet e telekomunikimeve, të japë licenca dhe të zgjidhë mosmarrëveshje ndërmjet të licencuarve dhe klientëve;

"Aksione" do të ketë kuptimin e përcaktuar në parashtrimet e kësaj Marrëveshjeje;

"Data e nënshkrimit" do të kuptohet dita e fundit e nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje nga Shitësi dhe Blerësi siç tregohet në faqet e nënshkruara të kësaj Marrëveshjeje;

"Garanci" do të kuptohen deklarimet dhe garancitë e dhëna nga Shitësi Blerësit dhe nga Blerësi Shitësit në nenin 7.